



Rekomandime për pavarësinë dhe llogaridhënien e gjyqësorit

(Rekomandimet e Varshavës)

2023



OSCE
ODIHR

Rekomandime për pavarësinë dhe llogaridhënien e gjyqësorit

(Rekomandimet e Varshavës)

2023



Mirënjohje: Ky dokument ka përfituar veçanërisht nga kontributet e dhëna nga Siniša Milatović, Kees Sterk, Gar Yein Ng, Susie Alegre dhe Marta Achler.

*Rekomandimet për pavarësinë dhe llogaridhënien e gjyqësorit
(Rekomandimet e Varshavës) 2023*

Publikuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut
Rr. Miodowa 10
00-251 Varshavë
Poloni


www.osce.org/odihr

© OSCE/ODIHR 2025

ISBN 978-92-9271-430-7

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij publikimi mund të përdoret dhe kopjohet lirisht për qëllime edukative dhe të tjera jokomerciale, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me një njohje të OSBE-së/ODIHR-it si burim.

Dizajnuar nga Dejan Kuzmanovski



Përmbajtja

Hyrja	1
Pjesa I. Këshillat gjyqësorë dhe organet vetëqeverisëse	3
Pavarësia dhe paanshmëria e këshillave gjyqësorë dhe organeve vetëqeverisëse	3
Përbërja e këshillave gjyqësorë	3
Ndarja e kompetencave për administrimin e gjyqësorit	4
Zgjedhja e anëtarëve gjyqtarë të këshillave gjyqësorë dhe organeve vetëqeverisëse	4
Zgjedhja e anëtarëve jo-gjyqtarë në këshillat gjyqësorë dhe organet vetëqeverisëse	5
Integriteti i anëtarëve të këshillave gjyqësorë dhe të organeve vetëqeverisëse	5
Pjesa II. Llogaridhënia e këshillave gjyqësorë dhe organeve vetëqeverisëse	6
Parimet e përgjithshme të llogaridhënies	6
Masat e llogaridhënies	6
Komunikimi me organet tjera shtetërore dhe publikun	7
Kufijtë e llogaridhënies	7
Roli i këshillave gjyqësorë dhe i organeve vetëqeverisëse në zgjedhjen e gjyqtarëve	7
Procedurat disiplinore për anëtarët e këshillave gjyqësorë	8
Imuniteti funksional i anëtarëve të këshillave gjyqësorë	8
Pjesa III. Organet dhe procedurat disiplinore	9
Marrëdhënia ndërmjet procedurës disiplinore dhe imunitetit gjyqësor	9
Anëtarësia e organeve që vendosin mbi disiplinën	9
Gjykata si organ disiplinor	10
Garancitë procedurale në procedurën disiplinore	10
Fillimi i procedurës disiplinore	11
Formulimi i shkeljeve disiplinore	11
Marrëdhënia ndërmjet shkeljeve disiplinore dhe kodit të etikës	11
Marrëdhënia ndërmjet procedurës disiplinore dhe vlerësimit të gjyqtarëve	11
Pjesa IV. Liria e shprehjes dhe liria e asociimit të gjyqtarëve	12
Liria e shprehjes	12
Liria e asociimit	13

Pjesa V. Mandati gjyqësor dhe transferimi i gjyqtarëve përbrenda ose në gjykata tjera **14**

Mandati gjyqësor dhe afati i kufizuar	14
Transferimet, siguria e mandatit dhe mos-zhvendosja e gjyqtarëve	14
Transferime dhe riorganizimet e gjykatave	14
Transferimet dhe sanksionet disiplinore	15
Paanësia dhe transparenca gjatë transferimeve gjyqësore	15
Transferimet dhe roli i kryetarëve të gjykatës	16
Transferimet dhe roli i këshillave gjyqësorë	16
Transferimet dhe vlerësimet e performancës së gjyqtarëve	16

Pjesa VI. Barazia, diversiteti dhe mosdiskriminimi **17**

Përfaqësimi i burrave, grave dhe i pakicave në gjyqësor	17
Politikat për avancimin e barazisë gjinore në gjyqësor	18
Barazia dhe mosdiskriminimi	18

Hyrje

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë njohur pavarësinë e gjyqtarëve dhe funksionimin e paanshëm të shërbimit publik gjyqësor si një nga elementët e drejtësisë që është thelbësor për shprehjen e plotë të dinjitetit të qenësishëm dhe të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjitha qenieve njerëzore (Kopenhagë 1990). Ato janë angazhuar më tej për të garantuar që pavarësia e gjyqësorit të garantohet me ligj dhe të respektohet në praktikë (Moskë 1991). Gjetja dhe mbajtja e një baraspeshe ndërmjet pavarësisë së gjyqësorit dhe llogaridhënies së gjyqtarëve është një proces dinamik.

Që nga publikimi i tyre në 2010, [*Rekomandimet e Kievit për Pavarësinë e Gjyqësorit në Evropën Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore*](#), të zhvilluara nga ODIHR-i së bashku me Institutin Max Planck për të drejtën e krahasuar publike dhe ndërkombëtare (MPI), kanë shërbyer për të artikuluar përputhjen me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mira për reformat e sistemit gjyqësor në tërë rajonin e OSBE-së. Ato janë përdorur gjerësisht nga autoritetet kombëtare, shoqëria civile, OSBE-ja dhe organizatat të tjera ndërkombëtare.

Në vitin 2019, në përgjigje të kërkesave të shumta për udhëzime për çështje që lidhen me pavarësinë e gjyqësorit që bien jashtë fushëveprimit gjeografik dhe tematik të *Rekomandimeve të Kievit*, ODIHR-i filloi një proces gjithëpërfshirës konsultativ të drejtuar nga ekspertë për të siguruar që rekomandimet e tij për pavarësinë e gjyqësorit t'i përgjigjen në mënyrë efektive ndaj sfidave aktuale. Takimi inaugurues i një grupi bërthamë ekspertësh u mbledh në Varshavë, i ndjekur nga një vlerësim i mëtejshëm i gjerë i fushave tematike në fokus. *Rekomandimet për Pavarësinë dhe Llogaridhënien e Gjyqësorit (Rekomandimet e Varshavës)* janë rezultat i këtij procesi rishikimi.

Grupe të punës dhe ato këshillimore, të përbëra nga ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë nga i gjithë rajoni i OSBE-së, i dhanë ODIHR-it udhëzime dhe komente të vlefshme. Nga viti 2020 deri në vitin 2022, ODIHR-i mbajti një seri prej dhjetë seminaresh rajonale në të gjithë rajonin e OSBE-së për të dëgjuar pikëpamjet dhe perspektivat e një game të gjerë ekspertësh. Mbi 250 specialistë të sundimit të ligjit — duke përfshirë gjyqtarë dhe anëtarë të shoqatave të gjyqtarëve, organe për trajnime gjyqësore, autoritete legjislative dhe ekzekutive, avokatë, anëtarë të organizatave të shoqërisë civile, akademikë, anëtarë të stafit të zyrave në terren të OSBE-së dhe anëtarë të stafit nga organizatat rajonale dhe ndërkombëtare dhe nga organet shkencore — morën pjesë në procesin e rishikimit të ODIHR-it në pika të ndryshme. Një pamje e detajuar e kornizës praktike dhe normative të pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit në rajonin e OSBE-së u shfaq ngadalë.

Në përputhje me mënyrën se si u zhvilluan dhe në kuadër të mandatit të ODIHR-it për të mbështetur shtetet pjesëmarrëse në respektimin e angazhimeve të tyre lidhur me sundimin e ligjit, *Rekomandimet për Pavarësinë dhe Llogaridhënien e Gjyqësorit (Rekomandimet e Varshavës)* synojnë të ofrojnë një mjet praktik për palët e interesuara në të gjithë rajonin e OSBE-së, të cilët angazhohen me sistemet e drejtësisë në të gjitha pikat e kontaktit. Sikurse *Rekomandimet e Kievit*, *Rekomandimet e Varshavës* nuk janë gjithëpërfshirëse. *Rekomandimet e Varshavës* synojnë të plotësojnë *Rekomandimet e Kievit* duke shtjelluar disa çështje të patrajtuara më parë dhe për t'iu përgjigjur zhvillimeve që nga viti 2010. Të dy dokumentet duhet të lexohen së bashku. Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen në *Rekomandimet e Varshavës*, *Rekomandimet e Kievit* mbeten të zbatueshme. Në disa vende, *Rekomandimet e Varshavës (RV)* përdorin *Rekomandimet e Kievit (RK)* si pikënisje. Në atë rast, referencat shkruhen brenda kllapave në tekst; për shembull, (*Shih KR 1*).

Pjesa I

Këshillat gjyqësorë dhe organet vetëqeverisëse

Pavarësia dhe paanshmëria e këshillave gjyqësorë dhe e organeve vetëqeverisëse

1. Në kuadër të rolit të tyre në ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit në tërësi, këshillat gjyqësorë dhe organet vetëqeverisëse, në rastet kur janë të themeluara, duhet të jenë të pavarura dhe të paanshme.

Përbërja e këshillave gjyqësorë

2. Kur themelohet këshilli gjyqësor, ai duhet të përbëhet nga një shumicë e vogël anëtarësh nga radhët e gjyqtarëve të zgjedhur nga kolegët e tyre. Anëtarët gjyqtarë të këshillave gjyqësorë duhet të përfaqësojnë gjyqësorin në përgjithësi, duke përfshirë gjyqtarë nga gjykatat e nivelit të parë. Këshillat gjyqësorë nuk duhet të dominohen nga gjyqtarë të apelit apo gjykatave të tjera të shkallëve më të larta. Kur kryetari i një gjykate emërohet në këshillin gjyqësor, ai ose ajo duhet të japë dorëheqjen nga posti i tij/saj si kryetar/e i/e gjykatës. Për të promovuar gjithëpërfshirje dhe transparencë, këshillat gjyqësorë duhet të kenë një përbërje pluraliste me një përfaqësim të larmishëm të profesionistëve ligjorë, duke përfshirë profesorë të drejtësisë, përfaqësues të avokatishë dhe anëtarë me përvojë dhe të respektuar të shoqërisë civile me një histori të gjatë e të demonstruar në nxitjen e pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit. Për të promovuar pavarësinë e gjyqësorit, në rastet kur prokurorët nuk i përkasin të njëjtit organ të drejtësisë si gjyqtarët, ata duhet të përjashtohen nga këshillat gjyqësorë. *(Shih RK 7).*
3. Në këshillat gjyqësorë nuk duhet të ketë anëtarë nga pushteti ekzekutiv apo legjislativ. Në rast se anëtarët e tillë janë tashmë pjesë e këshillit, ata nuk duhet të kenë të drejtë të votojnë ose të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse në lidhje me çështjet e pavarësisë së gjyqësorit, duke përfshirë përgjegjësinë disiplinore, vlerësimin, transferimin, përzgjedhjen ose emërimin e gjyqtarëve. Rregullat në lidhje me përbërjen e këshillave gjyqësorë dhe zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të tyre duhet të hartohen për të siguruar baraspeshën dhe diversitetin gjinor. *(Shih RK 7).*

Ndarja e kompetencave rreth administrimit gjyqësor

4. Ndonjëherë, për të shmangur përqendrimin e tepruar të pushtetit në një organ gjyqësor dhe perceptimin e korporatizmit, kompetencat ndahen ndërmjet organeve vetëqeverisëse gjyqësore ashtu që organeve të veçanta u besohen detyra specifike të administrimit gjyqësor si përzgjedhja, promovimi dhe trajnimi i gjyqtarëve, disiplinimi, vlerësimi i performancës dhe buxheti. *(Shih RK 2)*. Në këto rrethana:
- (a) Të gjitha këto organe duhet të jenë të pavarura nga degët ekzekutive dhe legjislative të qeverisë, si dhe të lira nga çdo presion i jashtëm i panevojshëm. Anëtarët e tyre duhet të përfitojnë nga garancitë e pavarësisë të ngjashme me ato të gjyqtarëve;
 - (b) Organet e tilla nuk duhet të përdoren për të përmbysur pavarësinë e organeve të tjera vetëqeverisëse gjyqësore;
 - (c) Përbërja e çdo organi duhet të pasqyrojë kërkesat e funksionit të tyre;
 - (d) Puna e këtyre organeve duhet të rregullohet me ligj dhe jo me dekret ekzekutiv; dhe
 - (e) Efikasiteti dhe efektiviteti i këtyre organeve duhet të merret në konsideratë dhe të rivlerësohet periodikisht.

Zgjedhja e anëtarëve nga radhët e gjyqtarëve në këshillat gjyqësorë dhe organet vetëqeverisëse

5. Procedura e zgjedhjes së gjyqtarëve si anëtarë të këshillave gjyqësorë duhet të jetë e lirë nga ndërhyrjet e pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, ose nga autoritetet gjyqësore jashtë këshillit gjyqësor. Rezultatet e zgjedhjeve duhet të konsiderohen të detyrueshme për autoritetet ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore (pa paragjykuar procesin e shqyrtimit gjyqësor) dhe përfshirja e tyre në procedurën zgjedhore nuk duhet të ndryshojë vullnetin e votuesve.

Zgjedhja e anëtarëve jo-gjyqtarë në këshillat gjyqësorë dhe organet vetëqeverisëse

6. Anëtarët jo-gjyqtarë të këshillave gjyqësorë duhet të emërohen nga subjekte që janë të pavarura nga pushteti ekzekutiv, legjislativ ose gjyqësor, si universitetet dhe shoqatat e avokatëve. Kur subjektet e tilla nuk ekzistojnë, ose nuk përfaqësojnë interesat e kategorisë së anëtarëve jo-gjyqtarë që zgjidhen për këshillin gjyqësor, anëtarët jo-gjyqtarë, si p.sh. persona nga organizatat e shoqërisë civile, mund të emërohen nga kolegët e tyre. Anëtarët jo-gjyqtarë duhet të zgjidhen me shumicë të cilësuar nga një legjislaturë, gjë që kërkon një konsensus të gjerë në parlament. Nëse nuk arrihet kompromisi, anëtarët duhet të vazhdojnë në pozitat e tyre dhe mund të merren parasysh masat kundër bllokimit.

Integriteti i anëtarëve të këshillave gjyqësorë dhe të organeve vetëqeverisëse

7. Integriteti i kandidatëve për këshilla gjyqësorë dhe organe të tjera vetëqeverisëse (anëtarë gjyqtarë dhe jo-gjyqtarë) mund të vlerësohet nga organe të përbëra nga persona me pozitë të lartë morale, përfshirë ekspertë ndërkombëtarë, me procedurë të përcaktuar me ligj. *(Shih KR 22 për një përshkrim të parimeve që duhet të zbatohen nëse kontrollet e historikut kryhen në kontekstin e vlerësimit të integritetit të kandidatëve për këshilla gjyqësorë.)*. Vendimet e këtyre organeve duhet t'i nënshtrohen rishikimit gjyqësor. Vëzhgimi i pavarur dhe i paanshëm i emërimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të këshillave gjyqësorë mund të promovojë llogaridhënien dhe transparencën.

Pjesa II

Llogaridhënia e këshillave gjyqësorë dhe e organeve vetëqeverisëse

Parimet e përgjithshme të llogaridhënies

8. Për të mirën e individëve, shoqëria u beson këshillave gjyqësorë dhe organeve të tjera kompetenca për të vetëqeverisur gjyqësorin për të lehtësuar dhe mbrojtur pavarësinë e gjyqtarëve në vendosjen e çështjeve. Këshillat gjyqësorë dhe organet e tjera vetëqeverisëse duhet t'i japin llogari për kompetencat e tyre shoqërisë. Si organe të cilave u janë besuar kompetenca të gjera, ato kanë një detyrë përkatësisht të lartë për të dhënë llogari për to.
9. Me qëllim të fitimit dhe ruajtjes së besimit të shoqërisë, këshillat gjyqësorë dhe organet e tjera vetëqeverisëse duhet të zhvillojnë kulturën e llogaridhënies, që do të thotë se duhet të japin llogari për veprimet e tyre, edhe pa detyrimin ligjor për ta bërë këtë. Thelbi i kësaj kulture duhet të jetë dhënia e llogarisë për veprimet e tyre, përveç nëse ka arsye legjitime për të mos bërë një gjë të tillë. Vendimi i një këshilli gjyqësor ose organi tjetër vetëqeverisës për të mos dhënë llogari për diçka duhet të merret vetëm në situata kur kjo mund të rrezikojë ose të shihet si rrezikim i pavarësisë së gjyqësorit.

Masat e llogaridhënies

10. Këshillat gjyqësorë dhe organet vetëqeverisëse duhet të përdorin një sërë instrumentesh për të siguruar llogaridhënien e tyre. Ata duhet të bëjnë publike një gamë sa më të gjerë informacioni, duke përfshirë raportet e tyre vjetore, publikime të vendimeve të arsyetuara, kontaktet me shtypin, procedurat e këshillit, nivelin e shpërblyerit dhe shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e tjera zyrtare të anëtarëve të këshillit, pasurinë e anëtarëve të këshillit dhe disponueshmëria dhe përdorimi i burimeve zyrtare si automjetet dhe apartamentet që i përkasin këshillit. Ky informacion duhet të jetë i disponueshëm në formate të ndryshme dhe të qasshme, duke përfshirë edhe formatin për personat me aftësi të kufizuara dhe në gjuhët jo-shumicë.

Komunikimi me organet e tjera shtetërore dhe publikun

11. Këshillat gjyqësorë duhet të angazhohen në dialog të rregullt me organet e tjera shtetërore, duke përfshirë edhe pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ, për të siguruar funksionimin efektiv të organeve gjyqësore. Për të rritur besimin e publikut nëpërmjet rritjes së kontrollit dhe llogaridhënies së aktiviteteve të tyre, këshillat gjyqësorë duhet gjithashtu të angazhohen në dialog të shpeshtë dhe të rregullt me shoqërinë civile, median dhe publikun në përgjithësi, dhe duhet të marrin masa të tilla si prezantimi i procedurave të ankesave, kryerja e anketave të kënaqësisë së përdoruesve dhe aktivitete në terren.

Kufijtë e llogaridhënies

12. Këshillat gjyqësorë nuk duhet të japin informacion ose të angazhohen në dialog për rastet individuale në mënyrë parajudhëse. Ata nuk duhet të japin informacion dhe as të angazhohen në dialog për punën e gjyqtarëve individualë. Këshillat gjyqësorë duhet të paraqiten për dialog përpara parlamentit ose organeve të tjera mbi baza vullnetare dhe vetëm për të shqyrtuar çështjet e politikës, legjislacionit, llojet e rasteve dhe çështje të tjera që lidhen me funksionimin e gjyqësorit në përgjithësi, dhe jo në lidhje me rastet ose gjyqtarët individual. Anëtarët e këshillave gjyqësorë nuk duhet të shkarkohen nga ekzekutivi ose legjislativi përpara përfundimit të mandatit të tyre, përveç atëherë kur shpallen përgjegjës për vepra të rënda disiplinore ose penale.

Roli i këshillave gjyqësorë dhe i organeve vetëqeverisëse në përzgjedhjen e gjyqtarëve

13. Për të promovuar llogaridhënien dhe transparencën, organeve përzgjedhëse duhet t'u kërkohej me ligj që të nxjerrin vendime të arsyetuara. Ndërsa rezultatet e procesit të përzgjedhjes duhet të bëhen publike, arsyetimi i vendimeve të përzgjedhjes duhet të mbetet konfidencial dhe të mos publikohet. Organet përzgjedhëse duhet të përgatisin një përmbledhje të mjaftueshme të arsyetimit të shumicës së tyre, duke dhënë arsytet për renditjen e kandidatëve dhe nominimin për emërim në kuadër të kriterëve të paracaktuar. Ky dokument duhet të vihet në dispozicion të kandidatëve sipas kërkesës së tyre, pas përfundimit të procesit të nominimit. Vendimet e përzgjedhjes duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor nga një organ i pavarur dhe i paanshëm. Nëse rishikimi gjyqësor inicohet nga një kandidat, mund të parashikohet një përjashtim nga rregulli i konfidencialitetit. Kjo mund t'i lejojë gjykatës të ketë qasje në informacionin në lidhje me vlerësimin e kandidatit dhe pikët e kandidatëve të tjerë, ndërkohë që do të vendosë detyrimin për palët në procedurë për të mbajtur informacionin konfidencial. Këshillat gjyqësorë duhet të zhvillojnë rregulla të qarta etike për sjelljen e anëtarëve të tyre në lidhje me përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve. Këshilli gjyqësor duhet të zhvillojë kriterë objektive për emërimet diskrecionale, veçanërisht në postet e larta, duke iu përmbajtur kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e gjyqtarëve të përcaktuara më sipër. *(Për procesin e përzgjedhjes në përgjithësi, shih RK 3, 4 dhe 21-23).*

Procedura disiplinore për anëtarët e këshillave gjyqësorë

14. Procedurat disiplinore për anëtarët e këshillave gjyqësorë duhet të zhvillohen nga organe që nuk kanë anëtarë të këshillit gjyqësor. Këto organe mund të krijohen posaçërisht me ligj dhe vendimet e tyre duhet të jenë të arsyetuara dhe t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor. Anëtarët e këshillave gjyqësorë që i nënshtrohen procedurave disiplinore duhet të kenë të njëjtat garanci procedurale si gjyqtarët që i nënshtrohen procedurave të tilla (*shih RV 19 më poshtë*).

Imuniteti funksional i anëtarëve të këshillave gjyqësorë

15. Anëtarët e këshillave gjyqësorë duhet të gëzojnë vetëm imunitet funksional, duke përfshirë pikëpamjet, fjalimet dhe votat e shprehura publikisht. Anëtarët e këshillave gjyqësorë që kryejnë vepra penale gjatë kryerjes së detyrave të tyre nuk duhet të kenë imunitet nga ndjekja penale (*shih RV 16 më poshtë*).

Organet dhe procedurat disiplinore

Marrëdhënia ndërmjet procedurës disiplinore dhe imunitetit gjyqësor

16. Procedurat disiplinore synojnë të mbajnë gjyqtarët përgjegjës për sjelljen e tyre, ndërsa imuniteti gjyqësor shërben për t'i mbrojtur ata nga ndjekja e pajustificuar për ushtrimin e funksioneve të tyre të ligjshme gjyqësore. Gjyqtarët mund të kenë përgjegjësi penale ose civile si individë të tjerë kur nuk ushtrojnë funksione gjyqësore. Gjyqtarët që kryejnë një vepër penale gjatë ushtrimit të detyrës nuk duhet të kenë imunitet nga ndjekja penale.

Anëtarësia e organeve që vendosin për disiplinën

17. Organet që vendosin për rastet e disiplinës gjyqësore nuk duhet të kontrollohen nga pushteti ekzekutiv dhe as nuk duhet të ketë ndonjë ndikim politik që ka të bëjë me disiplinën gjyqësore. Duhet të shmangët çdo lloj kontrolli nga pushteti ekzekutiv mbi organet që u është besuar disiplina gjyqësore. Organet kompetente për të shqyrtuar një çështje disiplinore dhe për të marrë një vendim për masat disiplinore duhet të jenë të pavarura dhe nuk duhet të përfshijnë anëtarë në shërbim të ekzekutivit ose legjislativit. Organet që gjykojnë çështjet e disiplinës gjyqësore nuk duhet të kenë anëtarë që kanë kompetencën ligjore për të nisur ato procedura. Organet disiplinore duhet të përbëhen nga një shumicë gjyqtarësh, të zgjedhur nga kolegët e tyre, dhe të përfshijnë anëtarë jashtë profesionit të gjyqësorit, duke përfshirë anëtarë me përvojë dhe të respektuar të organizatave të shoqërisë civile me një histori të dëshmuar të gjatë në nxitjen e pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit. (*Shih RK 9. Shih gjithashtu RK 1, 25-26*). Anëtarët gjyqtarë të organeve disiplinore nuk duhet të marrin pjesë në përzgjedhjen apo emërimin e gjyqtarëve dhe as të kryejnë funksione të tjera që lidhen me administrimin e gjyqësorit. Rregullat në lidhje me përbërjen e organeve disiplinore dhe zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të tyre duhet të hartohen për të siguruar baraspeshë dhe diversitet gjinor.

Gjykatat si organe disiplinore

18. Ndër modelet e ndryshme të sistemit disiplinor gjyqësor, në disa kontekste, procedurat disiplinore ndaj gjyqtarëve mund të gjykohen në shkallë të parë nga gjykatat.

Garancitë procedurale gjatë procedurës disiplinore

19. Organet kompetente për të shqyrtuar një çështje disiplinore dhe për të marrë vendim për masat disiplinore duhet të sigurojnë garanci procedurale për gjyqtarët që i nënshtrohen procedurave disiplinore. Këto duhet të përfshijnë të drejtën për një gjykatë të paanshme dhe të pavarur, për t'u informuar plotësisht për akuzat kundër tyre dhe të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të marrë një vendim brenda një kohe të arsyeshme.
20. Më tej, organet që vendosin për rastet e disiplinës gjyqësore duhet të respektojnë parimin e barazisë së armëve, duke përfshirë të drejtën për përfaqësim për gjyqtarin e akuzuar, për t'u ndihmuar nga një avokat sipas përzgjedhjes së tyre dhe të drejtën për të paraqitur mbrojtjen, duke përfshirë të drejtën për të pasur qasje në prova. Transparenca duhet të jetë rregull për seancat disiplinore të gjyqtarëve. Seancat duhet të jenë të hapura, përveç nëse gjyqtari i akuzuar kërkon që ato të mbyllen. Seancat nuk duhet të mbyllen automatikisht me kërkesë të gjyqtarit; përkundrazi, kërkesat e tilla duhet të shqyrtohen për secilin rast veç e veç, me ç'rast gjykata kompetente duhet të vendos nëse kërkesa është e arsyeshme. (*Shih RK 26*).
21. Gjatë fazës së hetimit, gjyqtari i akuzuar mund të suspendohet vetëm përkohësisht, në rrethana të jashtëzakonshme dhe me pagesë. Të gjitha vendimet për pezullimin e përkohshëm të një gjyqtari gjatë një hetimi disiplinor duhet të përmbajnë një vendim të arsyetuar që paraqet ndikimin paragjykses në administrimin e drejtësisë që do të ndodhte nëse gjyqtari do të vazhdonte të shërbente.
22. Vendimet që merren gjatë procedurës disiplinore duhet të jenë të arsyetuara mirë dhe të konstatojnë gjetjet thelbësore, provat dhe arsyetimin ligjor. Ata mund të ankimohen në një gjykatë kompetente, vendimi i së cilës duhet të jetë i detyrueshëm për këshillat dhe organet gjyqësore që vendosin për rastet e disiplinës gjyqësore. Vendimet përfundimtare për masat disiplinore duhet të publikohen. (*Shih RK 26*). Kur procedura disiplinore kundër një gjyqtari ndërpritet nga organi që vendos për rastet e disiplinës gjyqësore, kompetenca për të vendosur për këtë çështje nuk duhet të bartet tek organet e tjera, përfshirë gjykatat.

Fillimi i procedurës disiplinore

23. Anëtarët e organeve inicuese të procedurës disiplinore nuk duhen të jenë të njëjtë me ata që marrin vendim në procedurë të tillë. Për të siguruar një shqyrtim të pavarur dhe objektiv të ankesës, kryetarët e gjykatave nuk duhet të kenë kompetencë as të nisin procedura disiplinore dhe as të miratojnë një masë disiplinore. (*Shih RK 14*). Megjithatë, kryetarët e gjykatave mund të paraqesin ankesë tek një organ që është kompetent për pranimin e ankesave dhe kryerjen e hetimeve disiplinore. Organet që nisin procedurat disiplinore duhet të miratojnë një procedurë direkte për të hedhur poshtë pretendimet qëllimkeq të bëra kundër gjyqtarëve pa prova prima facie për një shkelje disiplinore.

Formulimi i shkeljeve disiplinore

24. Për të promovuar parimin e parashikueshmërisë dhe për të zbutur rrezikun e abuzimit dhe tejkalimit në zbatimin e bazave për procedura disiplinore, veprimet ose mosveprimet që përbëjnë shkelje disiplinore duhet të përcaktohen qartë me ligj. Sanksionet disiplinore duhet të jenë proporcionale me shkeljen disiplinore përkatëse.

Marrëdhënia midis shkeljeve disiplinore dhe kodeve të etikës

25. Ligjet dhe aktet nënligjore që përcaktojnë shkeljet disiplinore dhe sanksionet duhet të dallohen qartë nga kodet e etikës. Pavarësisht ndërveprimit ndërmjet tyre, rregullat etike nuk duhet të përdoren si bazë për procedura disiplinore dhe organet që mbikëqyrin shkeljet e normave etike duhet të jenë të ndara nga organet përgjegjëse për shqyrtimin e çështjeve disiplinore.

Marrëdhënia ndërmjet procedurës disiplinore dhe vlerësimit të gjyqtarëve

26. Procedura disiplinore dhe vlerësimet periodike të gjyqtarëve duhet t'i nënshtrohen procedurave të diferencuara qartë, të kryera nga organe të veçanta sipas standardeve të mirëpërcaktuara e të shpallura me ligj. Vlerësimi periodik i gjyqtarëve nuk duhet të përdoret për shkarkimin ose sanksionimin e gjyqtarëve në një mënyrë të ngjashme me sanksionet disiplinore. Vlerësimet e gjyqtarëve mund të përdoren për të ndihmuar gjyqtarët të identifikojnë aspekte të punës së tyre që ata mund të dëshirojnë t'i përmirësojnë dhe për qëllime të promovimit të mundshëm. (*Shih RK 28*).

Pjesa IV

Liria e shprehjes dhe liria e asociimit të gjyqtarëve

Liria e shprehjes

27. Liria e shprehjes është një e drejtë e garantuar ndërkombëtarisht e gjyqtarëve si individë. Kjo liri mund të kufizohet dhe t'i nënshtrohet kufizimeve të tilla që mund të jenë të nevojshme për të mbrojtur nderin dhe dinjitetin e detyrës gjyqësore dhe paanshmërinë dhe pavarësinë e gjyqësorit, nëse autoritetet ekzekutive, legjislative dhe/ose gjyqësore janë në gjendje të demonstrojnë se kufizimi i kësaj lirie është i parashikuar me ligj, ka një qëllim legjitim dhe është i nevojshëm e proporcional.
28. Gjyqtarët duhet të jenë në gjendje ta ushtrojnë këtë liri për të kontribuar në diskursin publik për çështje që prekin sundimin e ligjit dhe zgjedhjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë, por pa u kufizuar në debatet mbi legjislacionin, politikat që mund të ndikojnë në vetëqeverisjen gjyqësore dhe tema që ngrenë pyetje themelore në një shoqëri demokratike. Gjyqtarët gjithashtu kanë për detyrë të shprehen në mbrojtje të shtetit të së drejtës dhe pavarësisë së gjyqësorit në situata ku këto vlera kërcënohen.
29. Megjithatë, gjyqtarët duhet të tregojnë kujdes të veçantë në ushtrimin e kësaj të drejte kur përdorin mediat sociale dhe kur ndërveprojnë me shtypin, duke pasur parasysh nevojën e lartpërmendur për të mbrojtur nderin dhe dinjitetin e detyrës së tyre, si dhe nevojën për t'u përmbajtur nga komentet të cilat mund të paragjykojnë perceptimin e paanshmërisë së gjyqësorit në shqyrtimin e çështjeve që i kanë para vetes.

Liria e asociimit

30. Liria e organizimit është një e drejtë e garantuar ndërkombëtarisht e gjyqtarëve si individë. Kjo e drejtë mund të përdoret nga gjyqtarët, pa asnjë dallim, për të formuar dhe bashkuar shoqata gjyqtarësh dhe organizata të tjera, duke përfshirë sindikatat, për të promovuar interesat e tyre dhe parimet e pavarësisë dhe të llogaridhënies së gjyqësorit. Gjyqtarët gjithashtu mund ta ushtrojnë këtë të drejtë për të formuar dhe për t'u bashkuar me shoqërinë civile dhe organizatat jofitimprurëse si organizatat bamirëse, me kusht që objektivat e tyre të mos jenë të natyrës politike. Megjithatë, kjo e drejtë mund të kufizohet dhe t'i nënshtrohet kufizimeve të tilla që mund të jenë të nevojshme kur formimi ose bashkimi me një shoqatë do të binte ndesh me detyrat publike dhe/ose do të rrezikonte paanshmërinë e gjyqtarëve ose perceptimin e paanshmërisë së tyre. Një kërkesë e detyrueshme që gjyqtarët të zbulojnë anëtarësimin e tyre në shoqata dhe ta bëjnë këtë informacion publik, mund të kufizojë padrejtësisht të drejtat e gjyqtarëve për lirinë e organizimit.

Mandati gjyqësor dhe transferimi i gjyqtarëve brenda ose ndërmjet gjykatave

Mandati gjyqësor dhe afatet e kufizuara

31. Siguria e mandatit të gjyqtarëve është një parakusht kryesor i pavarësisë së gjyqësorit. Me përjashtim të mundshëm të emërimeve me afat të caktuar për gjyqtarët e gjykatave kushtetuese dhe organeve ekuivalente, gjyqtarët nuk duhet të emërohen me mandate të kufizuara, pasi kjo rrezikon pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre. Preferohet që gjyqtarët që emërohen për herë të parë të mos emërohen për një periudhë prove, përveç në rrethana të jashtëzakonshme dhe vetëm për një periudhë të shkurtër pa mundësi zgjatjeje.

Transferimet, siguria e mandatit dhe mos-zhvendosja e gjyqtarëve

32. Mos zhvendosja e gjyqtarëve është një aspekt thelbësor i pavarësisë së tyre. Gjyqtarët nuk duhet të jenë nën kërcënimin e transferimit nga një gjykatë në tjetrën, pasi kjo mund të përdoret për të ushtruar presion ndaj tyre dhe për të sulmuar pavarësinë e tyre. Gjyqtarët duhet të transferohen brenda ose ndërmjet gjykatave vetëm me pëlqimin e tyre të dhënë lirisht, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme. Një mungesë e perceptuar ose faktike e drejtësisë dhe transparencës në praktikën që lidhet me transferimet gjyqësore mund të dobësojë pavarësinë e brendshme të gjyqtarëve dhe mund të dëmtojë garancitë e sigurisë së qëndrimit të tyre në detyrë dhe të mos zhvendosjes.

Transferimet dhe riorganizimi i gjykatave

33. Transferimi i gjyqtarëve ose masa të tjera ekuivalente, në parim, mund të arsyetohen në raste të jashtëzakonshme të riorganizimit legjitim institucional, që përgjithësisht rezulton në mbylljen e një gjykate ose ulje të kompetencës ose juridiksionit territorial të saj në një masë të tillë që punësimi i një gjyqtari nuk është më i mundur apo i arsyeshëm. Një ristrukturim i tillë gjyqësor duhet të inicohet me vendim ose rekomandim të një organi të pavarur gjyqësor. Në rastet e jashtëzakonshme kur

një gjykatë mbyllet ose ristrukturohet thelbësisht, të gjithë anëtarët ekzistues të asaj gjykate, në parim, duhet të rëmërohen në gjykatën zëvendësuese (nëse mund të zbatohet një gjë e tillë), ose të emërohen në një zyrë tjetër gjyqësore me status dhe mandat të njëjtë. Kur kjo mundësi nuk ekziston, gjyqtarit në fjalë duhet t'i jepet kompensim i plotë për humbjen e detyrës. Gjithashtu, në raste të tilla, emërimi në një post tjetër do t'i nënshtrohet procedurës së ankesës përpara një gjykate dhe/ose një autoriteti tjetër të pavarur, i cili do të vlerësojë legjitimitetin e transferimit. Transferimi i gjyqtarëve në kuadër të riorganizimit të gjykatave nuk duhet të shërbejë si mekanizëm për ndërhyrje ekzekutive apo legjislative në pavarësinë e gjyqësorit. Transferimet gjyqësore të bëra në kontekstin e riorganizimit të gjykatave duhet të respektojnë parimet e përgjithshme të pëlqimit, drejtësisë dhe transparencës (*shih WR 35 më poshtë*) në masën më të madhe të mundur.

Transferimet dhe sanksionet disiplinore

34. Si rregull i përgjithshëm, transferimi nuk duhet të përdoret si metodë sanksioni disiplinor formal ose joformal. Në juridiksionet ku ekziston mundësia e transferimit gjyqësor si formë e sanksionit disiplinor, ligji duhet të përcaktojë qartë se në cilat rrethana dhe sipas çfarë procedurash mund të zbatohet dhe këto duhet të jenë në kuadër të procedimeve të zakonshme disiplinore. Kushtet dhe procedurat për transferimin gjyqësor duhet të rregullohen në ligjin parësor për t'u mbrojtur kundër përdorimit të transferimit gjyqësor si formë e sanksionit të fshehur ose joformal.

Drejtësia dhe transparenca në transferimet gjyqësore

35. Gjyqtarët duhet të transferohen brenda ose ndërmjet gjykatave vetëm me pëlqimin e tyre të dhënë lirisht, me përjashtim të delegimeve të përkohshme, të cilat duhet të përdoren vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Për të parandaluar perceptimin e nepotizmit, korrupsionit ose ndikimeve të tjera të padrejta, transferimet e gjyqtarëve brenda ose ndërmjet gjykatave duhet të kryhen përmes një procesi aplikimi në të cilin kriteret për transferim përcaktohen në mënyrë të qartë dhe ku organi përgjegjës për të vendosur mbi transferimet sqaron arsyetimin e bazuar ligjërish për transferimin ose refuzimin e tij. Këtu përfshihen transferimet e gjyqtarëve për qëllime të menaxhimit të burimeve njerëzore. Konkursët për transferime në pozitë të njëjtë me detyra të tjera duhet të bëhen gjithmonë publike. Transferimet për qëllime të avancimit në karrierë dhe/ose promovimit duhet të kryhen sipas procedurave të rregullta të përcaktuara për këtë qëllim. Ligji duhet të parashikojë shprehimisht të drejtën për një rishikim të plotë gjyqësor të procedurës dhe të përmbajtjes së të gjitha vendimeve për transferimin gjyqësor. Kalimet ose delegimet e gjyqtarëve në gjykata ose institucione të tjera duhet të jenë për një kohë të caktuar dhe të kufizuar; jo më shumë se gjashtë muaj.

Transferimet dhe roli i kryetarëve të gjykatave

36. Ndërsa kryetarët e gjykatave duhet të kenë fleksibilitetin për të transferuar gjyqtarët përbrenda gjykatës ose në një zyrë tjetër gjyqësore me status të barabartë dhe me mandat të njëjtë, ata duhet ta bëjnë këtë në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente. Çdo transferim i tillë duhet të bëhet vetëm me pëlqimin e plotë me shkrim të gjyqtarit që transferohet. *(Shih WR 35 më lart)*.

Transferet dhe roli i këshillave gjyqësorë

37. Duhet të përcaktohen rregulla dhe procedura të qarta për çdo rol për këshillat gjyqësorë ose organet e tjera vetëqeverisëse në lidhje me çështjen e transferimit të gjyqtarëve. *(Shih Pjesën I dhe II më lart)*.

Transferimet dhe vlerësimi i performancës së gjyqtarëve

38. Vlerësimi i performancës mund të përdoret si mjet objektiv gjatë një procesi konkurrues për transferimet gjyqësore anësore ose hierarkike.

Barazia, diversiteti dhe mos diskriminimi



Ju lutemi shihni publikimin e ODIHR-it [Gjinia, Diversiteti dhe Drejtësia: Përmbledhje dhe Rekomandime](#) për një analizë gjithëpërfshirëse të sfidave dhe të praktikave të mira që lidhen me një gjyqësor gjithëpërfshirës.

Përfaqësimi i burrave, grave dhe pakicave në gjyqësor

39. Këshillat gjyqësorë, organet e tjera vetëqeverisëse (duke përfshirë panelet e përzgjedhjes dhe të rekrutimit) dhe gjykatat e shkallëve më të larta duhet të kenë përbërje të balancuar gjinore me përfaqësim adekuat të pakicave. (*Shih RV 2 dhe RV 17 më lart*).
40. Autoritetet ekzekutive, legjislativë dhe gjyqësore duhet të miratojnë masa për të siguruar barazinë gjinore në organet vetëqeverisëse gjyqësore dhe në pozitat e larta në gjyqësor. Ato duhet të konsiderojnë miratimin e masave të ngjashme për të siguruar përfaqësimin adekuat të pakicave. (*Shih KR 24*). Këto autoritete duhet të miratojnë tregues dhe udhëzime të mëtijshme për matjen e barazisë gjinore dhe përfaqësimit adekuat të minoriteteve në gjyqësor përtej përfaqësimit në këto pozita. Këto mund të përfshijnë përfaqësimin e grave dhe pakicave në shkollat dhe akademitë gjyqësore, shkallën e promovimeve të grave dhe pakicave në poste të larta pas marrjes së pushimit prindëror dhe politikave për të siguruar që i jepet peshë e barabartë përvojës së karrierës në fushat e ligjit të parë në mënyrë stereotipike si ligje për 'femra', siç është ligji për familjen dhe ligji i mirëqenies sociale. Këta tregues duhet të jenë cilësor dhe sasior dhe duhet të fokusohen në barazinë e mundësive dhe të rezultatit de facto dhe de jure.

Politikat për avancimin e barazisë gjinore në gjyqësor

41. Këshillat gjyqësorë dhe organet e tjera vetëqeverisëse duhet të avancojnë barazinë gjinore në mënyrë proaktive në kontekstin e funksioneve të tyre dhe në gjyqësor në përgjithësi. Masat mund të përfshijnë ushtrime periodike të hartës gjinore dhe miratimin e planeve të integritetit gjinor, trajnime për gjyqtarët dhe personelin gjyqësor për të rritur ndërgjegjësimin për barazinë gjinore dhe për të siguruar që t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë gjyqtaret, si dhe trajnime për të luftuar ngacmimet seksuale për gjyqtarët dhe stafin gjyqësor. Më tej, këshillat gjyqësorë dhe organet e tjera vetëqeverisëse duhet të zhvillojnë kritere dhe procedura promovimi që u ofrojnë kandidatëve femra mundësi të barabarta dhe që zbusin paragjykimet e vetëdijshme ose të pavetëdijshme të vendimmarrësve. Kjo duhet të përfshijë gjithashtu sigurimin që menaxhimi i burimeve njerëzore brenda gjyqësorit të jetë i ndjeshëm ndaj gjinisë dhe diversitetit, ndër të tjera duke rishikuar politikat e burimeve njerëzore dhe qasjen në përfitimet sociale në kuadër të konsideratave gjinore dhe të diversitetit si dhe duke promovuar një ekuilibër më të mirë punë-familje për profesionistët e sektorit të drejtësisë, në veçanti duke kapërcyer hendekun gjinor në qasjen në pushimin prindëror. Këshillat gjyqësorë dhe organet e tjera vetëqeverisëse duhet të sigurojnë se ekzistojnë politika dhe procedura efektive disiplinore të cilat përmbajnë dispozita që ndalojnë diskriminimin ose ngacmimin në bazë të gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor ose arsyeve të tjera, bulizmit dhe ngacmimet seksuale ose forma të tjera të sjelljes së gabuar. Dispozitat dhe procedurat duhet të përfshijnë një mekanizëm efektiv për ankesë dhe t'i përfshijnë të gjithë punonjësit e sistemit gjyqësor, duke garantuar siguri, konfidencialitet dhe përshtatshmëri të procesit të ankimit krahas një procesi të hetimit të përcaktuar qartë dhe të pavarur.

Barazia dhe mos diskriminimi

42. Diskriminimi i drejtpërdrejtë (trajtimi diferencial i paarsyeshëm) dhe diskriminimi indirekt (rregullat, rregulloret ose procedurat në dukje neutrale që shkaktojnë trajtim të paarsyeshëm të diferencuar) në procesin e vetëadministrimit, përzgjedhjes, emërimit, transferimit dhe disiplinës gjyqësore duhet të ndalohen me ligj dhe duhet të ekzistojnë mekanizma efektivë për të siguruar një përgjigje adekuate ndaj rasteve të diskriminimit në praktikë. Më konkretisht, duhet të ndalohet diskriminimi nga shoqërimi (kur dikush trajtohet ndryshe në bazë të shoqërimit me një prejardhje ose karakteristikë të caktuar personale) në procesin e vetëadministrimit, përzgjedhjes, emërimit, transferimit dhe disiplinës gjyqësore. Duhet të ndërmerren hapa aktivë për të përjashtuar paragjykimet dhe stereotipet e pavetëdijshme, duke përfshirë ato bazuar në gjininë, aftësinë e kufizuar ose karakteristika të tjera ose të kaluar personale, nga vendimet në procesin e vetëadministrimit, përzgjedhjes, emërimit, transferimit dhe disiplinës gjyqësore.

